



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prima / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	28.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1660/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.118/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datë 11.02.2022 me numër A.nr.118/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **ANULOHE**T Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 01.02.2022, për ankuesin
- II. **OBLIGO**HET Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim, në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Obiliqit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë *rivlerësimin e rezultateve në punë* për ankuesin për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. **OBLIGO**HET Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të ndër marr veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në sipikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Akt emërimit të datës 03.02.2017 në vendin e punës “Inspektor i Ndërtimit”, në Sektorin për Inspektim, në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit, me datë 01.02.2022 ka pranuar formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin

2021 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij, respektivisht nga Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim, me të cilin ankuesin e ka vlerësuar për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021 me notën e përgjithshme mjaftueshëm 1.60.

Ankuesi, i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 të cilin e ka nënshkruar me datën 01.02.2022, e ka nënshkruar vlerësimin dhe ka shprehur mos pajtim lidhur me vlerësimin e rezultateve punës duke lënë komentin e tij se nuk pajtohet me vlerësimin e bere nga vlerësuesi, ndërsa Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim, pas mos pajtimit të ankuesit tek rubrika e komenteve shënon koment se qëndron mbrapa vlerësimit të punës për vitin 2021 për nëpunësin pasi që nuk i ka kryer detyrat e punës.

Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e Udhëheqësit të Sektorit për Inspektim -mbikëqyrësit të tij, me datën 11.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 691/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore që përcaktojnë obligimet e mbikëqyrësit dhe procedurën e vlerësimit nga mbikëqyrësi, se vlerësimi është bërë pa mbajtur asnjë takim paraprak nga ana e mbikëqyrësit të tij, dhe se vlerësimi ndaj tij nga ana e mbikëqyrësit është jo real dhe në kundërshtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Rregullores me numër Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 18.02.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa me datën 01.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Obiliqit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me numër protokolli 691/2022 të datës 11.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të punës; Plani nr. protokolli XV-04 i punës për vitin 2021 i datës 08.01.2021; Folder i datës 2021; Procesverbal i datës 18.01.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 20.01.2021; Procesverbal i datës 21.01.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 03.02.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 12.02.2021; Procesverbal i datës 24.02.2021; Procesverbal i datës 16.02.2021;

Procesverbal i datës 24.02.2021; Procesverbal i datës 02.03.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 04.03.2021; Procesverbal i datës 05.03.2021; Procesverbal i datës 08.03.2021; Procesverbal i datës 09.03.2021; Procesverbal i datës 16.03.2021; Procesverbal i datës 18.03.2021; Procesverbal i datës 25.03.2021; Procesverbal i datës 31.03.2021; Procesverbal i datës 02.04.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 05.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 12.04.2021 faqe 1/3; Procesverbal i datës 13.04.2021; Procesverbal i datës 15.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 26.04.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 27.04.2021; Procesverbal i datës 28.04.2021; Procesverbal i datës 29.04.2021; Procesverbal i datës 30.04.2021; Procesverbal i datës 06.05.2021; Procesverbal i datës 07.05.2021; Procesverbal i datës 11.05.2021; Procesverbal i datës 24.05.2021; Procesverbal i datës 26.05.2021; Procesverbal i datës 27.05.2021; Procesverbal i datës 01.06.2021; Procesverbal i datës 03.06.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 10.06.2021; Procesverbal i datës 1.06.2021; Procesverbal i datës 05.08.2021; Procesverbal i datës 06.08.2021; Procesverbal i datës 09.08.2021; Procesverbal i datës 12.08.2021; Procesverbal i datës 13.08.2021; Procesverbal i datës 30.08.2021; Procesverbal i datës 20.09.2021; Procesverbal i datës 21.09.2021; Procesverbal i datës 29.09.2021; Procesverbal i datës 04.10.2021; Procesverbal i datës 05.10.2021; Procesverbal i datës 12.10.2021; Procesverbal i datës 22.10.2021; Procesverbal i datës

25.10.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 28.10.2021; Procesverbal i datës 09.11.2021; Procesverbal i datës 12.11.2021 faqe ½; Procesverbal i datës 17.11.2021; Procesverbal i datës 18.11.2021; Procesverbal i datës 19.11.2021; Procesverbal i datës 25.11.2021; Procesverbal i datës 09.12.2021; Urdhëresë për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatarë të datës 24.02.2021, të datës 03.03.2021 të datës 25.03.2021 të datës 12.04.2021 të datës 15.04.2021 të datës 26.04.2021 të datës 13.08.2021; Lista e lëndëve të regjistruara faqe 1/8; Raport lidhur me inspektimet nga data 01.1.2021 -31.12.2021; E-mail i datës 24.02.2021; E-mail i datës 08.03.2021; E-mail i datës 05.03.2021; inspektim i datës 08.03.2021; E-mail i datës 09.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 11.03.2021 i datës 12.03.2021; Njoftim i datës 08.04.2021; E-mail i datës 4.04.2021; Raport lidhur me inspektimin e datës 13.04.2021; E-mail i datës 16.04.2021; E-mail –Raport i datës 27.04.2021; Raport lidhur me inspektimin e datës 26.04.2021; E-mail i datës 29.04.2021; shkresë e datës 28.04.2021 lidhur me pengesat e mbikëqyrjes inspektuese; E-mail i datës 30.04.2021; E-mail i datës 06.05.2021; Reagim i datës 06.05.2021; E-mail i datës 06.05.2021; E-mail i datës 12.05.2021; Raport i datës 12.05.2021; E-mail i datës 12.05.2021-deklarati; Deklarati e datës 12.05.2021; E-mail i datës 18.05.2021; E-mail i datës 24.05.2021; E-mail i datës 10.06.2021 ;E-mail i datës 23.11.2021 –Njoftim; E-mail i datës 26.11.2021 Raport MEDRUPALAST; E-mail i datës 01.12.2021; E-mail i datës 03.12.2021; E-mail i datës 16.12.2021; E-mail i datës 22.12.2021; E-mail i datës 30.12.2021; Raport i datës 31.12.2021; E-mail i datës 31.12.2021; E-mail i datës 02.02.2021; Vendim i datës 02.02.2021 për kompensim për punë jashtë orarit nr.11-59; Vendim nr.XV-27 i datës 10.02.2021; E-mail i datës 10.02.2021; Kërkesë e datës 10.02.2021; Vendim nr.II-127 i datës 03.03.2021; Email i datës 05.03.2021 –procesverbal; Email i datës 09.03.2021 –Njoftim; Shkresë e datës 08.03.2021 nga Inspektori; E-mail i datës 19.03.2021; Email i datës 06.03.2021 –vendim i Qeverisë CV-19; E-mail i datës 15.04.2021 Rekomandim; E-mail i datës 05.05.2021-Njoftim; E-mail i datës 07.05.2021-Kërkesë për plotësim dhe ndryshim e PZHK Obiliq; E-mail i datës 07.05.2021- scan personeli 007; E-mail i datës 18.05.2021-Njoftim dhe i datës 24.05.2021; E-mail i datës 26.05.2021 plan i zhvillimor; E-mail i datës 27.05.2021 plan i zhvillimor dhe me datë 25.05.2021; E-mail i datës 12.07.2021 –Komision hartat zonale; E-mail i datës 12.07.2021 dhe i datës 19.07.2021, Vendim –grupi mbështetës i punës; E-mail i datës 19.07.2021 –takim pune; E-mail i datës 19.07.2021-dëmet në bujqësi; E-mail i datës 21.07.2021-takim; E-mail i datës 01.09.2021; E-mail i datës 01.09.2021 Njoftim; E-mail i datës 27.09.2021 –draft HZK Obiliq i dt.30.07.2021; E-mail i datës 22.11.2021 –Njoftim; E-mail i datës 16.11.2021 –Njoftim; Aktvendim nr.XV-172 i datës 18.08.2021; Aktvendim nr.XV-171 i datës 18.08.2021; Fatura e datës 16.08.2021; Aktvendim nr.XV-101 i datës 14.05.2021; Fatura e datës 11.05.2021; Aktvendim nr.XV-84 i datës 28.04.2021; Aktvendim nr.XV-65 i datës 29.03.2021; Aktvendim nr.XV-42 i datës 09.03.2021; Fatura e datës 26.04.2021; Aktvendim nr.XV-72 i datës 16.04.2021; Aktvendim nr.XV-73 i datës 16.04.2021; Aktvendim nr.XV-33 i datës 25.02.2021; Aktvendim nr.XV-30 i datës 19.02.2021; Fatura e datës 04.03.2021; Aktvendim nr.XV-32 i datës 25.02.2021; Aktvendim nr.XV-31 i datës 25.02.2021; **Përgjigje në ankesë e datës 01.03.2021 me nr. protokoli 1074/2022**; Akte emërimi nr.II-105 i datës 03.02.2017 ; E-mail i datës 24.02.2022 njoftim rreth vlerësimit të zyrtarit E-mail i datës 23.02.2022 Njoftim për provat e kërkuara nga KPMSHCK-së; Dëshmi e datës 24.02.2022 nga bashkangjitur : Aktvendim nr.XV-38 i datës 08.03.2021; Kallëzimi penal Nr.XV-04 datës 12.01.2022i nxjerrë nga E-mail i datës 11.02.2022 lidhur me e-mailin e datës 09.02.2022; E-mail i datës 15.02.2022 me e-mailin e datës 15.02.2022; Rekomandim i datës 15.04.2021; Sqarim i datës 11.02.2021; E-mail i datës 16.12.2021 –Njoftim; E-mail i datës 20.04.2021-Përgjigje E-mail i datës 24.05.2021; E-mail i datës 05.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; Vendim Nr.XII-171 i datës 29.12.2021 I Komisionit disiplinor; Rekomandim i datës 18.05.2021 për Zyren Ligjore, nga për ndërprerje të punës për

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në **rivlerësim, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, gjegjësisht vlerësimi i është bërë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, i cili ka shtuar se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i është bërë pa pasur asnjë takim paraprak me mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë, dhe nuk i janë marrë për bazë as plani i punës për vitin 2021. Po ashtu, ankuesi thekson se formulari i vlerësimit i është dorëzuar në forme fizike me datë 01.02.2022, jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e nënshkrimit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: **“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.vlerësimin (notimi) e objektivave”**, sepse vlerësimi i është dërguar ankuesit në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: **“Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”**, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesi është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesi pasi ka pranuar vlerësimin, me datë 01.02.2022 ka paraqit me shkrim mospajtimin e tij, brenda afatit prej 5 ditëve, në pajtim me dispozitën e lartë cekur, dhe po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesin gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankuesit dhe organit të punësimit lidhur me mospajtimin e kryerjes së detyrave të punës për vitin 2021 siç ka komentuar mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, është vërtetuar se në përgjigjen e datës 01.03.2022 të Komunës së Obiliqit dërguar Këshillit me nr. protokollit 1074/2022, nuk është dëshmuar se është i hartuar plani i punës 2021 sipas përshkrimit të detyrave të punës, por në bazë të provave të bashkangjitura në ankesën e ankuesit del se plani i punës nuk është në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës sipas Akt emërimit” të datës 03.02.2017.

Kolegji po ashtu konstaton se plani vjetor i punës për vitin 2021, është hartuar në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : **“Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”**, sepse plani i punës duhet të hartohet gjithmonë me pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe nëpunësin, duke marrë për bazë përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit dhe nga ajo pjesë të caktohen objektivat përkatëse për realizimin e veprimtarive, siç ceket edhe në nenin 6 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : **“Brenda muajit janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi ( vlerësuesi) se bashku me**

*nëpunësin ( i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet”.*

Po ashtu ankuesi ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit nga I-III, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte sepse mos përfshirja e arritjes së objektivave për ankuesin në bazë të detyrave të punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e tij në punë, ku në ë bazë të provave, në vlerësim tek pesë (5) objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrat e tij të punës, e që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3,4,5,6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe duke u bazuar në përmbajtjen e vlerësimit të rezultateve në punë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se:” **1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësive në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë”**, andaj vlerësuesi/eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankuesit për vitin 2021, ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit konkretisht Udhëheqësi i Sektorit për Inspektim, me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme 1.60 tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesi me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj eprori aktual është i obliguar që ankuesit ti bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerre të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankuesit të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankuesit konkretisht Udhëheqësin e Sektorit për Inspektim, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021 për ankuesin si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji si fakt vendimtar lidhur me shqyrtimin e ankesës, mori parasysh edhe faktin notor se viti 2021 ishte vit i përcjellë me situatën e pandemisë me COVID-19, dhe si rezultat i kësaj të gjitha institucionet publike kanë funksionuar me staf esencial dhe reduktime të stafit, rrethana këto që Kolegji vlerëson se kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave të punës, andaj Kolegji bazuar në këto rrethana konstaton se


Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit duhet të bëjë rivlerësimin e Rezultateve të punës për vitin 2021, duke marrë parasysh të gjitha faktet e cekuar më lartë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.118/2022**

Zyle Millaku Gojnovci

  
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.